



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË RANILLUGUT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Ranillugut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ranillugut (KR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Ranillugut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Pasuritë kapitale mbi 1,000€, të raportuara në shumën 7,985,547€ në Pasqyra Financiare Vjetore janë nënvlerësuar për 69,219€, si dhe detyrimet kontigjente të raportuara në PFV në shumën 5,360€ janë nënvlerësuar për 30,641€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Ranillugut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave.
- A2 Mos respektimi i kriterëve të përcaktuara në shpalljen publike me rastin e pranimit në shërbimin civil.
- A3 Pranimi dhe përzgjedhja për furnizimin e minibusit jo në pajtim me dosjen e tenderit.
- B2 Mos verifikimi i pronave me qëllim mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Ranillugut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Ranillugut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Ranillugut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Ranillugut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Ranillugut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, që kanë të bëjnë me shpalosjen e pasqyrave financiare vjetore PFV, përzgjedhjen dhe pranimin e furnizimeve jo në pajtim me kushtet e kontratës, përzgjedhjen e stafit pa i plotësuar kriteret e konkursit, mos ndërmarrjen e veprimeve për inkasimin e borgjeve, regjistrimin dhe inventarizimin e pasurive jo financiare e të tjera. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, dhe katër (4) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Nënvlërësimi i pasurive jo financiare kapitale dhe detyrimeve kontingjente

Gjetja	<p>Neni 6 i Rregullores MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.</p> <p>Komuna në pasqyrat financiare vjetore (PFV) finale të dorëzuar në ministrinë e financave punës dhe transfereve (thesar) të datës 26.02.2025, nuk i kishte dorëzuar edhe anekset në excel për shpalosjet e PFV-ve, për më tepër detyrimet kontingjente të shpalosura në shumën 5,360€, ishin nënvlërësuar për 30,641€ për kontratën kolektive dhe kompensim dëmi, dhe pasuritë jo financiare kapitale të shpalosura në shumën 7,985,547€, ishin nënvlërësuar për 69,219€, për mos regjistrimin e blerjeve të vitit 2024 nga kategoria e investimeve kapitale për këtë shumë.</p> <p>Kjo ka ardhur si pasojë e mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme, që ka shkaktuar regjistrimin dhe raportimin e të dhënave financiare të jenë jo të plota.</p>
Ndikimi	Mos regjistrimi dhe shpalosja e plotë e të dhënave financiare për detyrimet kontingjente dhe pasuritë jo financiare ka ndikuar që pasqyrat vjetore financiare (PFV) të jenë jo të plota të sakta dhe drejta.
Rekomandimi B1	Kryetarja duhet të rrisë kontrollet gjatë përgatitjes së PFV-ve, në mënyrë që shpalosjet në PFV të mos përmbajnë gabime materiale kontabël apo tjetër. Në deklaratën e lëshuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë bërë të gjitha kontrollet e nevojshme në draft PFV-të.
Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)	

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave

Gjetja Neni 22 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet Urdhër blerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga auditimi kemi vërejt mangësitë si në vijim: në pesë (5) raste zotimi i mjeteve dhe urdhër-bleerja janë bërë pas datës së faturës dhe pranimit të mallit, kurse në një (1) rast tjetër urdhër blerja është proceduar pas datës së faturës dhe pranimit të mallit. Shuma totale e këtyre rasteve është 37,073€.

Kjo ka ndodhur për arsye të dështimit të kontrolleve nga zyra e prokurimit me rastin e procedimit të urdhër blerjes.

Ndikimi Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

Rekomandimi A1 Kryetarja duhet të sigurojë se zyra e prokurimit do të ndjek të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mos respektimi i kriterëve të përcaktuara në shpalljen publike me rastin e pranimit në shërbimin civil

Gjetja Sipas Rregullores Nr.15/2023 për procedurën e pranimit në shërbimin civil neni 6 paragrafi 2 thekson së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, po ashtu Vendimi i Qeverisë Nr.11/130 i datës 22.02.2023 dhe Vendimi i Qeverisë Nr.14/169 i datës 27.10.2023, kërkon verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës me qëllim të punësimit në institucionet e Republikës së Kosovës.

Gjatë auditimit të procedurave të rekrutimit të shërbyesve civil, kemi identifikuar çështjet në vijim:

- Për pozitën Zyrtar për ndihmë sociale kandidati/ja e përzgjedhur, nuk ka prezantuar dëshmi të përvojës së punës të lëshuar nga organizata apo institucione që veprojnë në Republikën e Kosovës.
- Për pozitën Zyrtar për kadastër kandidati/ja i përzgjedhur, nuk ka prezantuar Certifikatën e vlefshmërisë për diplomat e lëshuara nga

Universiteti i Mitrovicës së Veriut, nga Komisioni për Verifikimin e Diplomave.

Për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mos respektimit të procedurave e kritereve të konkursit nga anëtarët e komisionit të vlerësimit.

Ndikimi Përzgjedhja e kandidatëve jo meritore, që nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara cenon pabarazinë në përzgjedhje e punësuarve dhe kjo ndikon që mos të arrihen objektivat e përcaktuara të organizatës.

Rekomandimi A2 Kryetarja duhet të sigurojë se procedurat e rekrutimit të punonjësve të zhvillohen sipas kërkesave ligjore dhe kritereve të përcaktuara në shpalljen publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Pranimi dhe përzgjedhja për furnizimin e minibusit jo në pajtim më dosjen e tenderit

Gjetja Fleta e të dhënave të dosjes së tenderit (FTD) në piken 2.1 parasheh Blerjen e një minibusi për nevojat e Komunës së Ranillugut sipas specifikimeve teknike të detyrueshme, po ashtu pika 4.1 parasheh se “Variantet nuk janë të autorizuara, si dhe pika 9.2 kërkesat për mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkon që operatori ekonomike të ketë Certifikata ISO 9001 2015. Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Infrastrukturës Nr. 02/2018 për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologim të mjeteve rrugore, nenin 2.1.2 përcakton se; automjetet motorike të projektuara dhe ndërtuara kryesisht për transportimin e personave dhe bagazheve të tyre dhe të cilat përveç ulëses së vozitësit kanë më shumë sesa 8 ulëse - automjete të kategorisë M2 dhe M3, ndërlidhur me këtë, nenin 2.1.4 përcakton se; automjetet motorike të projektuara dhe ndërtuara kryesisht për transportin e mallrave, masa maksimale e të cilave kalon 3.5 tonë - automjete të kategorisë N2 dhe N3, dhe neni 18 paragrafi 1.5 parasheh pëlqimi për regjistrim.

Komuna kishte kontraktuar një minibus me 22 ulëse për nevojat e veta në vlerë 99,000€, ku kemi hasur çështje si në vijim:

- Automjeti i furnizuar ishte i prodhuar për kategorinë N2 me 2 ulëse automjete motorike të ndërtuara për transportin e mallrave, pastaj me 31 Tetor 2024 është kryer modifikimi në kategorinë M3 për 22 ulëse në bazë të pëlqimit nr. 7092/24 të homologimit të Qendrës së Automjeteve të Kosovës - EUROLAB dhe ka rezultuar në regjistrimin e automjetit/minibusit, ku në bazë të dosjes së tenderit variantet nuk janë të lejuara.
- Pas analizimit të dosjes së tenderit, kemi vërejtur që kërkesa për minibus ishte e kategorisë M2 ose M3 në mbështetje dhe sipas specifikimeve teknike të detyrueshme të tenderit, ndërsa OE fitues kishte dorëzuar ISO standardi 9001:2015 të prodhuesit të përshtatshëm për kategorinë e automjeteve N1 dhe N2 dhe të pakompletuar për kategorinë e automjeteve M2 dhe M3 përveç kësaj edhe në katalogun - certifikata e konformitetit të automjetit i përkiste kategorisë N2.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve për të siguruar që furnizimi dhe shpërblymi me kontratë të jetë sipas

kërkesave të kontratës dhe dosjes së tenderit.

Ndikimi Furnizimi me automjetin/minibusin e modifikuara/ndryshuara nga furgonet për mallra dhe jo në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, rrit rrezikun e keq përdorimit të parasë publike dhe të sigurisë së personave që udhëtojnë me këtë minibus.

Rekomandimi A3 Kryetarja duhet të sigurojë që shpërblimi dhe pranimi i furnizimeve të bëhet sipas kushteve të dosjes së tenderit dhe kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos verifikimi i pronave me qëllim mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë

Gjetja Nenit 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme pika 2 parasheh që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Në vitin 2024, nga 936 objekte të regjistruara, Komuna nuk ka arritur të kryej asnjë inspektim të pronave të paluajtshme, siç parashikon Ligji për tatimin mbi pronën e paluajtshme.

Kjo ka ndodhur sepse në njësinë e tatimit në pronë ishte i punësuar vetëm një punonjës dhe për arsye të vëllimit të punëve nuk ka arritur të kryej këtë kërkesës ligjore.

Ndikimi Mos inspektimi i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatuashme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi B2 Kryetarja duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Pasuritë jo financiare kapitale më vlerë mbi 1,000€ janë shpalosur në PFV 7,985,547€, pasuritë jo financiare jo kapitale më vlerë nën 1,000€ janë shpalosur në PFV 51,965€, nga auditimi kemi hasur çështje si në vijim:

Çështja A4 - Mos regjistrimi i pasurive jo financiare në sistemin e-pasuria

- Gjetja** Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.3 përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.
- Komuna nuk e kishte regjistruar pasurinë jo kapitale në sistemin e-pasuria. Të dhënat për pasurinë jo kapitale regjistrohen dhe evidentohen në formatin excel.
- Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit të brendshëm dhe procedurave teknike të sistemit e-pasuria.
- Ndikimi** Përdorimi i formateve alternative për regjistrimin e pasurisë jo kapitale ndikon negativisht në sigurinë, saktësinë, plotësinë dhe raportimin e drejtë të saj.
- Rekomandimi A4** Kryetarja duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin e sistemit e-pasuria për regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

- Gjetja** Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se: “Çdo fundvit bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, tutje neni 21 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare”, po ashtu neni 11.3 përcakton se: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësisë të pasurisë për përdorim do të zbatohet dhe zhvlerësimi”.
- Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk kishte bërë krahasimin (harmonizimin) e gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël, rrjedhimisht nuk dihet diferenca në mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit.
- Po ashtu nga raportet e vlerësimit të pasurive jo financiare kanë rezultuar në pasuri jo financiare jashtë përdorimit dhe të dëmtuara, si pasojë që akoma nuk ishte formuar komisioni për tjetërsimin e pasurive që do të rezultonte në përgatitjen e raportit për pasuritë që duhet të largohen nga

përdorimi dhe në përditësimin e regjistrave kontabël.

Gjithashtu duhet të theksojmë se nga analiza e shpalosjes dhe të dhënave të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ në PFV kemi vërejtur se akoma ka të regjistruara në kategorinë investime në vijim për vitet 2012 deri në vitin 2019 në vlerë totale 397,538€ të cilat përkundër që mund të jenë në përdorim, akoma mbahen në regjistra si pasuri në vijim.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme lidhur me zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Ndikimi

Mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare dhe mos regjistrimi i procesit të përmbylljes së investimit kapital ndikon në saktësinë, plotësinë dhe vlerësimin si rezultat i mos aplikimit të zhvlerësimit për investimet në vijim.

Rekomandimi A5

Kryetarja duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat, si dhe zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale sipas klasifikimit kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të shpalosura në pasqyrat financiare vjetore në shumën 786,534€ që kishin të bëjnë: më tatimin në pronë 445,931€, shitja e shërbimeve (mbeturinat) 213,687€, taksat në biznes 90,220€ dhe përdorimi i hapësirave publike 36,696€, ku kemi hasur si në vijim:

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesën, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendrike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në inkasimin e Llogarive të Arkëtueshmeve (LIA) pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Për mostrat tona nuk kemi vërejtur që komuna ka marr ndonjë veprim konkret për vitin 2024 për inkasimin e LIA. Pjesëmarrjen më të madhe e kanë të arkëtueshmet për tatimin në pronë janë 445,931€, ndjekur nga taksa në biznes prej 90,220€ dhe të tjerat janë 250,383€.

Dobësitë e identikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në menaxhimin përkatësisht inkasimin e tyre.

Ndikimi Mos inkasimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B3 Kryetarja duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për inkasimin e të hyrave, si dhe të forcojë kontrollin e brendshëm duke vendosur mekanizma të përshtatshëm për inkasimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna në vitin 2024 nuk ka funksionalizuar/themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB) dhe nuk ka vepruar konform rregullores QRK-Nr. 01/2019, neni 4 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm.

Çështja B4 - Mos funksionalizimi i NJAB

Gjetja Rregullorja QRK - Nr. 01/2019, neni 4 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektet e sektorit publik, neni 4 parasheh se: Subjekti i sektorit publik ka katër mënyra për të zbatuar auditimin e brendshëm; krijimin e njësisë së auditimit të brendshëm brenda komunës, një njësie të përbashkët me subjektet e tjera të sektorit publik, një marrëveshje me një subjekt publik për ofrimin e të auditimit ose kontraktimin e një kompanie profesionale.

Komuna gjatë vitit 2024 nuk kishte funksionalizuar shërbimin e njësisë së auditimit të brendshëm në asnjërën nga format që parasheh Rregullorja QRK - Nr. 01/2029 përkatësisht neni 4 për kryerjen e auditimeve të brendshme. Në prill të vitit 2025, kryetarja kishte nxjerr vendimin për kthim në punë të auditorit të brendshëm që këtë pozitë e kishte pezulluar me herët.

Menaxhmenti nuk ka treguar përgjegjshmëri dhe gatishmëri të duhur në fuqizimin e pikës së rëndësishme për monitorimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Mungesa e funksionimit të shërbimit të auditimit të brendshëm ndikon në uljen e efikasitetit të kontrolleve të brendshëm dhe monitorimit të mbarëvajtjes së aktiviteteve të punës në komunë.

Rekomandimi B4 Kryetarja duhet të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm të funksionalizohet, të përgatisë planin e auditimit të bazuar në rrezik dhe të kryhen auditimet konformë planifikimeve të parapara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	2,235,239	2,367,237	2,133,578	2,014,525	1,524,423
Grante Qeveritare - Buxheti	2,127,341	2,089,501	1,998,248	1,910,190	1,418,927
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	18,139
Të bartura nga viti i kaluar	0	149,890	58,966	49,420	60,156
Të hyrat vetanake	107,898	107,898	58,841	54,916	27,200
Donacionet e jashtme	0	19,947	17,524	0	0

Buxheti përfundimtar ishte më i lartë se buxheti fillestar për 131,998€. Kjo ishte rezultat i bartjes së të hyrave nga viti i kaluar për 149,890€, donacionet e jashtme për 19,947€ dhe zvogëlimin të buxhetit nga granti qeveritar për 37,839€.

Në vitin 2024, Komuna ka shpenzuar 90% të buxhetit final apo 2,133,578€, me një rritje për 1% krahasuar me shpenzimin e buxhetit të vitit 2023.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	2,235,239	2,367,237	2,133,578	2,014,525	1,524,423
Pagat dhe mëditjet	1,578,496	1,540,656	1,540,656	1,453,744	1,109,387
Mallrat dhe shërbimet	260,000	295,600	236,508	232,733	190,971
Komunalitë	52,000	79,752	46,635	36,888	35,425
Subvencionet dhe transferet	80,000	121,383	83,648	77,475	48,062
Investimet Kapitale	244,743	329,846	226,130	213,686	140,578
Rezervat	20,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 37,839€, krahasuar me buxhetin fillestar. Ky zvogëlim vjen nga Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 03/239 i datës 24.12.2024.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 35,600€. Kjo është si rezultat nga të hyrat vetanake të bartura për 33,365€ dhe nga donacionet e jashtme për 2,235€.
- Buxheti final për komunalit ishte rritur për 27,752€. Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetanake nga viti 2023.
- Buxheti final për subvencione ishte rritur për 41,383€, Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetanake nga viti 2023.
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 85,102€. Kjo rritje vjen nga transferi i rezervës për 20,000€, nga bartja e të hyrave vetanake nga viti 2023, në vlerë 47,390€, si dhe nga donacionet e jashtme në vlerë 17,712€. Shpenzimi i buxhetit për këtë kategori ishte rreth 69%, kjo ishte si rezultat i kontraktimeve në pjesën e dytë të vitit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2024 ishin 107,898€, përderisa ishin realizuar 114,636€. Po ashtu, Komuna për vitin 2024 ka pranuar të hyra nga gjobat e trafikut në vlerë prej 23,772€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	107,898	107,898	114,636	97,546	98,241
Të hyrat tatimore	41,956	41,956	54,843	42,885	35,552
Të hyrat jo tatimore	65,942	65,942	59,793	54,662	62,689

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 ka rezultuar në shtate (7) rekomandime. Komuna kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tre (3) rekomandime janë zbatuar, dhe katër (4) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të rrisë kontrollet gjatë përgatitjes së PVF-ve, në mënyrë që shpalosjet në PVF për vitin 2023 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Një deklaratë e lëshuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë bërë të gjitha kontrollet e nevojshme në draft PVF.	Edhe këtë vit kemi hasur në mos prezantimin dhe regjistrimin e plotë të pasurive jo financiare dhe detyrimeve kontingjente.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha detyrimet të paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.	Nuk kemi hasur në raste të tilla në vitin 2024.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që në rastin e angazhimit të nëpunësve për shërbime të veçanta, të respektohen procedurat dhe kriteret e prokurimit publik për të garantuar transparencën dhe konkurrencën e duhur. Gjithashtu, duhet të specifikohet dhe të përcaktohet afati i vlefshmërisë në kontratë.	Nuk kemi hasur në raste të tilla në vitin 2024.	I zbatuar

4.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.	Komuna nuk ka ndërmarr masa në verifikimin e pronave.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Pasuritë	Kryetarja duhet të sigurojë funksionimin e plotë të kontrolleve dhe monitorimin e komisionit të inventarizimit në mënyrë që raporti inventarizimit të jetë gjithëpërfshirës dhe të hartohet me kohë, para hartimit të PVF-ve.	Komuna ka përgatitur raportin e inventarizimit por nuk është bërë krahasimi me regjistrat kontabël.	I zbatuar
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari i komunës duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për mbledhjen e të hyrave, si dhe të forcojë kontrollin e brendshëm duke vendosur mekanizma të përshtatshëm për mbledhjen e tyre.	Komuna nuk ka ndërmarr masa në inkasimin e llogarive të arkëtueshmeve.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Auditimi i Brendshëm	Kryetarja duhet të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm të funksionalizohet në njërin nga mënyrat që përcakton rregullorja.	Në komunë nuk ka funksionuar shërbimi i auditimit të brendshëm në vitin 2024 ndërsa në Prill 2025 auditori i brendshëm është kthyer nga pezullimi ku do të përcillet implementimi i këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Hysen Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Fetah Osmani, Anëtar i ekipit



Arbresha Breznica Rama, Anëtare e ekipit



Granita Zenelaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

 <p>LETËR E KONFIRMIMIT</p> <p>Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve</p> <p>Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit</p> <p>Të nderuar,</p> <p>Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Ranillugut, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti"); • pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe • brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre. <p>Z. Katarina Ristiq Iliq  (Kryetari i komunës), Data: 04.qershor.2025 Ranilug</p> 	<table border="1"> <tr> <td>№ i protokollit/Doc. No.</td> <td>O.R.</td> </tr> <tr> <td>№ i P.V./№ i Kom. No./ 2025</td> <td>01-454/ 2025</td> </tr> <tr> <td>Titulli/Data/Date</td> <td>04.06.2025</td> </tr> <tr> <td colspan="2">ОПШТИНА РАНИЛУГ - КОМУНА Е РАНИЛУГ</td> </tr> </table>	№ i protokollit/Doc. No.	O.R.	№ i P.V./№ i Kom. No./ 2025	01-454/ 2025	Titulli/Data/Date	04.06.2025	ОПШТИНА РАНИЛУГ - КОМУНА Е РАНИЛУГ	
№ i protokollit/Doc. No.	O.R.								
№ i P.V./№ i Kom. No./ 2025	01-454/ 2025								
Titulli/Data/Date	04.06.2025								
ОПШТИНА РАНИЛУГ - КОМУНА Е РАНИЛУГ									

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.